



Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07 dhe 5/09), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

**THIRRJE PUBLIKE nr. 06/2013**  
për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2013

**I. LËNDA E SHPALLJES**

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

Grupi i masave	Emri i masës	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme (deri më)
121	Investimi për modernizimin e ekonomive bujqësore	
1.	Kulturat e drithërave	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri më 4.500.000,00 denarë
2.	Kulturat industriale (vajdhënese, furazhe dhe duhan)	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri më 4.500.000,00 denarë
123	Investime për përpunimin dhe marketingun e prodhimeve bujqësore	
1.	Kapacitetet përpunuese për përpunimin primar dhe finalizim të kulturave të drithërave	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri më 6.000.000,00 denarë
2.	Kapacitetet përpunuese për vezët	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues deri më 10.000.000,00 denarë

Grupi i masave	Emri i masës	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme (deri më)
Masa 131	Bashkimi ekonomik i ekonomive bujqësore për kryerje të përbashkët të veprimtarisë bujqësore dhe përkrahjes financiare për themelimin dhe funksionimin e kooperativave bujqësore Mjetet janë paraparë për: - Themelimin dhe funksionimin e kooperativave bujqësore të regjistruara në Regjistrin e kooperativave bujqësore pranë MBPEU - Organizim të aktiviteteve informative dhe promovuese për prodhimet bujqësore - Ndhimë e premive për sigurim si lloj kompensimi të pjesës së shpenzimeve për sigurim edhe atë në shumë që nuk do të kalojë 70% të shpenzimit për sigurim të kapaciteteve prodhuese të kooperativës bujqësore me kapacitet të vogël dhe 80% për sigurim të kapaciteteve prodhuese të kooperativës bujqësore me kapacitet të madh, por jo më shumë se 3.000.000 denarë në nivel vjetor - Investime për furnizim të makinave bujqësore në shumë prej 90% të vlerës së përgjithshme të furnizimit.	- deri më 6.000.000 denarë
Shpenzimet e pranueshme për bashkim ekonomik të ekonomive bujqësore për kryerje të përbashkët të veprimtarisë bujqësore	- Shpenzimet për vendosje të kooperativës bujqësore përveç se për kooperativat veç se tash themeluara; - Shpenzime për marrje me qira të hapësirave dhe objekteve për punë të kooperativës përveç se për kooperativat veç se tash themeluara; - Shpenzime për furnizim me pajisje kompjuterike, mobile për zyrë dhe softuer kompjuterik për planifikim, menaxhim, përcjellje dhe kontrollim përveç se për kooperativat veç se tash themeluara; - Bruto pagë për personat profesional për menaxhim me kooperativën bujqësore, punëtorë administrativ dhe teknik; - Shërbime të personave të tretë që merren me kontabilitet dhe revizion të punës së kooperativës bujqësore; - Shërbime të personave të tretë për edukim të personave të punësuar profesional në kooperativën bujqësore; - Shërbime të personave të tretë për organizim dhe realizim të programeve për trajnim të anëtarëve të kooperativës bujqësore duke përfshirë edhe shpenzimet e rugës dhe ditore të anëtarëve të kooperativës bujqësore në shumë e cila nuk kalon 800 denarë për pjesëmarrës në bazë ditore; dhe - Shpenzime për organizim të evenimenteve promovuese për tërheqje dhe zgjerim të anëtarësimit në kooperativë	- Shuma e shpenzimeve të pranueshme nuk mund të kalojë 100% të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme për vitin e parë të pagës mesatare të paguar në Republikën e Maqedonisë për vitin e kaluar, me ulje prej 20% për secilin vit të ardhshëm në periodë jo më të gjatë se pesë vjet.
Shpenzime të pranueshme për organizim të aktiviteteve informative dhe promovuese për prodhimet bujqësore	- Shpenzime për organizim dhe realizim të evenimenteve promovuese për promovim të kooperativës bujqësore dhe prodhimet e saj - Shpenzime për përpunimin e shtandëve dhe rregullim dhe pajisje të pjesës ekspozuese; - Shpenzime për shpërblime dhe materiale promovuese për anëtarët/themeluesit e formës organizative të bashkimit ekonomik të ekonomive bujqësore si pjesëmarrësit e të cilët ekspozojnë në manifestim/panair; - Shpenzimet ruogore dhe ditore të pjesëmarrësve për pjesëmarrje në manifestimet e panairëve dhe panairit si ekspozues; - Shpenzime për transportin e pajisjeve dhe prodhimeve të pjesëmarrësve për pjesëmarrje në manifestimet e panairëve dhe panairit si ekspozues; - Shërbime të personave të tretë për organizim të kampanjave promovuese për formën organizative të bashkimit ekonomik të ekonomive bujqësore dhe - Shërbimet për përpilimin e ueb faqes dhe mirëmbajtjen e ueb faqes	- deri më 6.000.000 denarë

**II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE**

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë për masat:

Subjektet	MASA 1
Ekonomi bujqësore e regjistruar në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural	Masa 121
Shoqëri dhe kooperative tregtare që plotësojnë kushte për kryerje të veprimtarisë në pajtim me	

Ligjin për shoqëri tregtare ose Ligjin për kooperativat, si dhe subjekte juridike që fillojnë me kryerjen e kësaj veprimtarie (kapacitetet përpunuese për kultura të drithërave dhe vezëve)	Masa 123
- Kooperativa ose subjekti juridik me veprimtari kryesisht nga sfera e bujqësisë dhe themeluar nga bartës të ekonomive bujqësore të regjistruar në NJVEB, - Kooperativa ose subjekti juridik me veprimtari kryesisht nga sfera e bujqësisë dhe themeluar nga bartës të ekonomive bujqësore të regjistruar në NJVEB dhe kapacitetet përpunuese për përpunimin e prodhimeve bujqësore-ushqimore dhe - Subjekt juridik nga sfera e bujqësisë i formuar nga shoqatë e prodhuesve bujqësor. - Kooperativa bujqësore e regjistruar në pajtim me Ligjin për kooperativa bujqësore (vetëm për mjetet e parapara për themelimin dhe funksionimin e kooperativave bujqësore të regjistruara në Regjistrin e kooperativave bujqësore pranë MBPEU për ndihmë për premi për sigurim si lloj kompensimi të pjesës së shpenzimeve për sigurim edhe atë në shumë që nuk do të kalojë 70% të shpenzimit për sigurim të kapaciteteve prodhuese të kooperativës bujqësore me kapacitet të vogël dhe 80% për sigurim të kapaciteteve prodhuese të kooperativës bujqësore me kapacitet të madh, por jo më shumë se 3.000.000, denarë në nivel vjetor si dhe për furnizim të makinave bujqësore ku ndihma nuk kalon 90% të vlerës së furnizimit.	Masa 131

**III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE**

Mjetet dedikohen për investime për furnizim të mjeteve të reja themelore, shpenzime operative në lidhje me mjetet e furnizuara dhe shpenzime të tjera të parapara me Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2013.

Përkrahja financiare do të paguhet në parim të bashkëfinancimit të investimeve të përfunduara dhe të paguara nga ana e shfrytëzuesit në shumë prej 50% të vlerës së shpenzimeve të lejuara të pranueshme për investime, ndërsa ndryshe nuk është e përcaktuar.

Shkalla e bashkëfinancimit për Masën 121 rritet në raste kur:

- Bëhet fjalë për investim të ekonomisë bujqësore bartës i së cilës është bujk i ri deri në 55%,
- Për investime në rajone me mundësi të kufizuara të prodhimtarisë bujqësore deri në 60%,
- Për investime në rajone me mundësi të kufizuara të prodhimtarisë bujqësore kur bartës i investimit është bujk i ri 65%,
- Për investime në bashkësi rurale ku nuk ka qasje 75%.

Shkalla e bashkëfinancimit për Masën 123 është 50% dhe ullet deri në 25% në raste kur:

- Bëhet fjalë për investime të ekonomisë bujqësore ku shtruesi i kërkesës është në rangun e ndërmarrjes së madhe në pajtim me madhësinë e subjektit të shënuar në Gjendjen aktuale të subjektit juridik

Përkrahja e dhënë financiare është e pakthyeshme.

**IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET**

Kërkesat për masat veç e veç dorëzohen në origjinal.

Një kërkesë mund të dorëzohet një kërkesë vetëm për një masë. Një kërkesë mund të shtrohet më së shumti 2 kërkesa të veçanta për masa të ndryshme duke marrë parasysh edhe masat e tjera nga Programi për zhvillim rural për vitin 2013.

Kushtet të cilat duhet të plotësojnë kërkesit e mjeteve janë përcaktuar me:

- Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2013 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/2013, 81/2013 dhe 155/2013),
- Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013 dhe 106/2013),
- Rregulloren për kushtet më të përafërta plotësuese për mbështetje të masave për zhvillim rural, shpenzime të pranueshme dhe shkalla e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masë të veçantë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2011 dhe 80/2013),
- Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve për masë për zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2011 dhe 80/2013).

Krahas Kërkesës së shtruar në mënyrë të rregullt dhe të kompletuar për shfrytëzimin e mjeteve për Masën 121 dhe dokumentacionit të nevojshëm, kërkesi është i obliguar të dorëzojë edhe Deklaratë se nuk ka shfrytëzuar mjete nga ky program gjatë tri viteve të kaluara, të nënshkruar në mënyrë të rregullt dhe të vërtetuar në noter. Deklarata është pjesë e dokumenteve për aplikim dhe mund të gjendet në pakon e dokumenteve për aplikim ose të merret nga internet faqja e Agjencisë.

Kërkesit të cilët kanë plotësuar kushtet për shfrytëzim të mjeteve për masat 121, 123 dhe 131 klasifikohen me pikë të përcaktuar në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve të masave për zhvillim rural.

**Kërkesat me numër të njëjtë të pikëve do të klasifikohen sipas datës dhe kohës së parashtrimit të kërkesës**

**Kërkesit nuk kanë të drejtë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkëfinancim me Agjencinë.**

Shfrytëzuesit e mjeteve duhet ti kenë të paguara të gjitha obligimet financiare ndaj Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave si dhe obligimet financiare për vitin 2012 ndaj Ndërmarrjes publike për ekonomizim me kullosat dhe kompensimet e ujitjes ndaj ndërmarrjeve të ekonomisë së ujërave.

**V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE**

Formulari – Kërkesa për shfrytëzim të mjeteve së bashku me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhezimin e shfrytëzuesve mund të merret në ueb faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk), dhe në qendrat më të përafërta rajonale ose njësitë punuese të Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30.

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejtë në Agjencinë në adresën:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,  
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20  
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)  
1000 Shkup

**VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE**

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzim të mjeteve dhe kërkesat për pagesë nga Programi për përkrahje financiare për zhvillim rural për vitin 2013 së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 06/2013 dhe shënimin e shifrës së masës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arrijen jo në kohë ose të pakompletuar apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

**Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 15.01.2014. Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.**

Informata më të detajuara në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe në ueb faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Kontakt:



## AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për lejim të projekteve. Dhe Sektori për lejim të pagesave.

Telefoni **02 3097 - 460**, çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 16.30  
E-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)